



Ne baze te nenit 12, paragrafi 2, shkronja (d), të Ligjit, Nr.03/L-040, për Vetëqeverisjen Lokale, “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.28/2008”, e në mbështetje të nenit 6, të Ligjit, Nr.06/L-079, për eficiency e energjisë “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 21/2018”, e konform nenit 15, lidhur me nenin 29, pika 2, te Statutit te Komunës se Suharekës, 01-Nr-8336, i datës 04.11.2008, si dhe shkresës me numër Nr. 386 të datës 22.01.2024, të lëshuar nga Ministra e Ekonomisë në Prishtinë, Kuvendi i Komunës në Suharekë në mbledhjen e mbajtur me datën, -----, miraton këtë:

Projekt-V E N D I M

Neni 1

Me këtë vendim miratohet Plani Komunal i Veprimit për Eficiency e Energjisë për periudhën 2024-2026 (në tekstin e mëtejme PKVEE)

Neni 2

Pjesë përbërse e këtij vendim është edhe plani komunal i veprimit për eficiency e energjisë për periudhën 2024-2026 (në tekstin e mëtejme PKEE) i cila ka marr vlerësimin nga Ministria e Ekonomisë, sipas shkresës me numër Nr. 386 të datës 22.01.2024 se i njëjte është në përputhje me objektivat e eficiency së energjisë në kuadër të Strategjisë së Energjisë së Republikës së Kosovës për periudhën 2022-2031, si dhe programit për zbatimin e Strategjisë së energjisë së Kosovës për periudhën 2022-2025 dhe legjislacionit përkatës për energji.

Neni 3

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës dhe Drejtoret e Drejtorive te Komunës së Suharekës.

Neni 4

Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës në Suharekë, ky vendim hyn në fuqi 15, ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81, të Ligjit Nr. 03/L-040 për vetëqeverisjen lokale, “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 28/2008” dhe nenit 8, lidhur me nenin 9, të Rregullores, Nr. 10/2019, për procedurat e hartimit dhe publikimin e akteve të Komunave, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren (QRK) Nr. 06/2021 të datës 23.10.2021 dhe pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose web-faqen zyrtare të Komunës.

KUVENDI I KOMUNËS NË SUHAREKË

Kryesuesi i Kuvendit

Mr.ec Bexhet KUÇI

01-Nr-_____
Me datë _____